

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 299, datë 17.11.2025

STRATEGJIA E ERE PËR NDËRGJEGJËSIMIN MBI KURSIMITIN E ENERGJISË DHE PËRDORIMIN E BURIMEVE ALTERNATIVE

Afati kohor: 2025–2030

Institucionet: Enti Rregullator i Energjisë (ERE) & Agjencia e Eficiencës së Energjisë (AEE)

1. Hyrje

Energjia është një nga faktorët kryesorë jo vetëm për zhvillimin ekonomik të një vendi, por edhe për cilësinë e jetës së qytetarëve. Disponueshmëria e energjisë, kostoja e saj dhe mënyra se si menaxhohet, ndikojnë drejtpërdrejt në aktivitetin ekonomik, funksionimin e bizneseve dhe shërbimet publike, si dhe në shëndetin dhe mirëqenien e familjeve. Në kontekstin shqiptar, sektori energjetik po përjeton një transformim të thellë dhe progresiv, duke përfshirë integrimin e burimeve të rinovueshme, si energjia diellore dhe ajo e erës, dhe adoptimin e teknologjive të avancuara për menaxhimin dhe shpërndarjen më efikase të energjisë.

Megjithatë, përtej përmirësimeve teknologjike, një nga sfidat kryesore mbetet rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve për kursimin dhe përdorimin racional të energjisë. Ndryshimi i sjelljes së konsumatorëve dhe promovimi i përdorimit të burimeve alternative, janë elementë kyç për arritjen e eficiencës energjetike në të gjithë nivelet: familjar, biznese dhe institucione publike. Për këtë arsye, edukimi i konsumatorit dhe ofrimi i mjeteve për menaxhimin e energjisë janë po aq të rëndësishme sa investimet infrastrukturore.

Ky dokument synon të paraqesë një strategji afatmesme bashkëpunimi mes Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe Agjencisë për Eficiencën e Energjisë (AEE). Strategjia përfshin objektiva të qarta, modalitete konkrete të implementimit dhe rolin e ERE në arritjen e tyre. Përveç kësaj, ajo fokusohet tek bashkëpunimi ndër-institucional, duke krijuar ura komunikimi dhe koordinimi midis aktorëve të ndryshëm të sektorit energjetik, dhe tek mbrojtja e interesave të konsumatorit. Qëllimi është të sigurohet një qasje e integruar, që kombinon politikat rregullatore, promovimin e burimeve të rinovueshme, dhe masat për eficiencë energjetike, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

2. Sfondi dhe motivimi

Shqipëria po përballet me një sërë sfidash të rëndësishme në sektorin energjetik, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në stabilitetin e furnizimit, zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së qytetarëve:

- **Rritja e konsumit të energjisë elektrike dhe trysnia mbi rrjetin e shpërndarjes:** Konsumi i energjisë po rritet vazhdimisht, si pasojë e zhvillimit ekonomik, urbanizimit

Miraturar me Vendimin e bordit të ERE nr. 299, datë 17.11.2025

dhe rritjes së përdorimit të pajisjeve elektrike në familje dhe biznese. Kjo krijon presion mbi rrjetin ekzistues të shpërndarjes, duke e bërë më të vështirë menaxhimin e ngarkesave dhe garantimin e furnizimit të pandërprerë.

- **Nevoja për integrim të energjisë diellore, erës dhe burimeve të tjera alternative:** Për të reduktuar varësinë nga burimet konvencionale dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e sistemit, është e domosdoshme përdorimi i energjisë së rinovueshme. Kjo përfshin zhvillimin e kapaciteteve të energjisë diellore, erës, si dhe teknologjive të tjera inovative që mund të kontribuojnë në diversifikimin e burimeve energjetike.
- **Nivel i ndërgjegjësimit të konsumatorëve mbi kursimin dhe menaxhimin eficient të energjisë:** Një sfidë e madhe mbetet sjellja e konsumatorëve, të cilët shpesh nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi mënyrat e kursimit të energjisë, përdorimin racional të pajisjeve dhe mundësitë për të reduktuar shpenzimet. Ndërgjegjësimi i ulët çon jo vetëm në humbje financiare për familjet dhe bizneset, por edhe në ngarkesë shtesë mbi rrjetin energjetik.
- **Sfida lidhur me faturimin, pikat e konsumit me humbje energjie dhe mungesën e informacionit mbi opsionet alternative:** Problemet në sistemin e faturimit, si dhe humbjet e energjisë në pikat e konsumit, ndikojnë negativisht në efikasitetin e sektorit. Po ashtu, mungesa e informacionit mbi opsionet alternative dhe teknologjitë që mund të ndihmojnë në uljen e konsumit energjetik kufizon mundësitë e qytetarëve për të adoptuar zgjidhje më të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, roli i institucioneve rregullatore dhe promovuese është kyç:

- **Enti Rregullator i Energjisë (ERE):** Ka përgjegjësi kryesore për mbikëqyrjen e tregut të energjisë, rregullimin e tarifave dhe mbrojtjen e konsumatorit. ERE siguron që proceset e faturimit, shpërndarjes dhe tarifimit të jenë transparente dhe të drejtë për të gjithë aktorët e tregut.
- **Agjencia për Eficencën e Energjisë (AEE):** Ka përgjegjësi për promovimin e efikasitetit energjetik, zhvillimin e materialeve edukative, kryerjen e analizave teknike dhe hartimin e udhëzimeve për përdorimin e burimeve alternative. AEE ndihmon qytetarët dhe bizneset të kuptojnë mënyrat më efektive për të kursyer energji dhe për të adoptuar teknologji të gjelbërta.

Bashkëpunimi midis ERE dhe AEE është thelbësor për të arritur efekt maksimal në ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe përdorimin racional të energjisë. Vetëm përmes koordinimit të politikave rregullatore, promovimit të edukimit dhe ofrimit të informacionit teknik të qartë mund të arrihet një sistem energjetik më i qëndrueshëm, efikas dhe i orientuar drejt qytetarëve.

3. Qëllimi i strategjisë

Qëllimi kryesor i strategjisë është ndërtimi i një platforme (*ketu e në vijim Platforma*) mes Entit Rregullator të Energjisë (ERE), e cila synon të përmirësojë menaxhimin e energjisë dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve për përdorimin racional dhe eficient të saj. Platforma ka potencialin të veprojë si një mjet për koordinimin e politikave, promovimin e inovacionit dhe

Miraturar me Vendimin e bordit të ERE nr. 299, datë 17.11.2025

monitorimin e performancës së masave të implementuara. Në këtë kontekst, objektivat kryesore të platformës janë:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve mbi kursimin dhe efincën e energjisë:

Konsumatorët luajnë një rol kyç në efincën e sistemit energjetik. Platforma do të ofrojë informacione të qarta dhe të strukturuar mbi mënyrat për të kursyer energji në shtëpi, në biznes dhe në institucionet publike. Kjo përfshin këshilla praktike, udhëzime për përdorimin optimal të pajisjeve elektrike, promovimin e instrumenteve të matjes dhe monitorimit të konsumit, si dhe nxitjen e sjelljeve të qëndrueshme që reduktojnë shpenzimet dhe ndikimin mjedisor.

2. Promovimi i përdorimit të burimeve alternative të energjisë:

Platforma do të ketë një rol aktiv në edukimin e qytetarëve dhe bizneseve mbi përfitimet e energjisë së rinovueshme, duke përfshirë energjinë diellore, energjinë e erës dhe teknologjitë e tjera inovative. Përmes materialeve informuese, udhëzimeve teknike dhe shembujve praktikë, do të nxitë përdorimin e burimeve alternative, reduktimin e varësisë nga burimet konvencionale dhe rritjen e qëndrueshmërisë energjetike.

3. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional:

Një nga elementët kryesorë për suksesin e strategjisë është koordinimi mes ERE dhe AEE, por edhe midis institucioneve të tjera shtetërore, operatorëve të rrjetit dhe aktorëve privatë. Platforma do të funksionojë si një vitrinë informacioni, duke lehtësuar shpërndarjen, shkëmbimin e informacionit, harmonizimin e politikave dhe implementimin e masave që bashkojnë objektivat e ERE me ato të AEE. Ky bashkëpunim do të sigurojë që iniciativat të jenë të qëndrueshme, të koordinuara dhe të fokusuar drejt rezultateve konkrete.

4. Krijimi i mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit:

Për të matur efektivitetin e strategjisë, platforma do të përfshijë mekanizma të qartë monitorimi dhe vlerësimi. Kjo përfshin matjen e nivelit të ndërgjegjësimit të konsumatorëve, përdorimin e energjisë dhe adoptimin e teknologjive alternative, rritjen e numrit të njësive të banimit që kanë aplikuar normat më të mira teknike ndërtuese për rritjen e efincës së energjisë, etj. Të dhënat e mbledhura do të analizohen për të identifikuar sukseset, dobësitë dhe zonat që kërkojnë përmirësim. Kjo qasje e bazuar në të dhëna do të sigurojë vendimmarrje të informuar dhe përshtatje të vazhdueshme të strategjisë për rezultate më të larta.

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 299, datë 17.11.2025

4. Objektivat e strategjisë

4.1 Objektiva Kryesore

Objektivat e platformës së Entit Rregullator të Energjisë (ERE) janë të dizajnuara për të përmirësuar menaxhimin e energjisë, për të rritur ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe për të promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve energjetike. Këto objektiva kryesore përfshijnë:

1. **Edukimi dhe informimi i konsumatorëve për praktikën e kursimit të energjisë dhe përdorimin eficient të pajisjeve elektrike:**

Një nga prioritetet kryesore është ndryshimi i sjelljes së konsumatorëve. Platforma do të ofrojë materiale edukative, udhëzime praktike dhe këshilla për përdorimin optimal të pajisjeve elektrike në shtëpi, biznese dhe institucione. Kjo përfshin teknika për uljen e konsumit në kohë piku të lartë, përdorimin e pajisjeve me efikasitet energjetik të certifikuar dhe adoptimin e praktikave të menaxhimit të energjisë që reduktojnë shpenzimet dhe ndikimin mjedisor.

2. **Zhvillimi i standardeve për përdorimin racional të energjisë në biznes dhe institucione:**

Për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të energjisë në sektorin publik dhe privat, do të ketë udhëzime që orientojnë institucionet dhe bizneset drejt praktikave më efikase. Këto standarde do të përfshijnë kriteret për matjen dhe raportimin e konsumit energjetik, përdorimin e pajisjeve me efikasitet të lartë dhe integrimin e masave për uljen e humbjeve të energjisë.

3. **Promovimi i burimeve alternative të energjisë:**

Platforma do të nxisë adoptimin e teknologjive të rinovueshme, përfshirë panelet diellore, dhe sistemet e magazinimit të energjisë. Informacioni do të përqëndrohet në përfitimet ekonomike dhe mjedisore të këtyre burimeve, mundësitë e financimit dhe stimulimet e mundshme, si dhe shembuj praktikë të implementimit të tyre në shtëpi, biznese dhe institucione publike.

4. **Integrimi i praktikave të efikasitetit energjetik në rrjetin e shpërndarjes dhe në politikën e tarifimit:**

Përveç edukimit të konsumatorëve, platforma do të mbështesë hartimin e politikave dhe praktikave që përmirësojnë efikasitetin e rrjetit energjetik. Kjo përfshin optimizimin e shpërndarjes së energjisë, reduktimin e humbjeve në rrjet dhe përshtatjen e tarifave për të stimuluar përdorimin racional të energjisë nga konsumatorët. Integrimi i këtyre masave do të ndihmojë në krijimin e një sistemi më të qëndrueshëm dhe më të efektshëm.

Miraturar me Vendimin e bordit të ERE nr. 299, datë 17.11.2025

5. Sigurimi i informacionit të qartë, transparent dhe të besueshëm për konsumatorët:

Një element kyç i strategjisë është ofrimi i informacionit të plotë dhe të lehtë për tu kuptuar për qytetarët dhe bizneset. Kjo përfshin të dhëna mbi masat e kursimit, teknologjitë alternative, mundësitë financiare dhe stimujt që ofrohen nga institucionet publike. Transparenca dhe besueshmëria e informacionit do të rrisin besimin e konsumatorëve dhe do të inkurajojnë adoptimin e praktikave më të mira për eficientë energjetike.

4.2 Objektiva të veçantë

- Të rritet pjesëmarrja e konsumatorëve në fushata ndërgjegjëse;
- Të stimulohet përdorimi i instrumenteve digjitale (llogaritës energjie, simulime, aplikacione mobile);
- Të zhvillohen materiale edukative të bazuara në evidenca dhe të aksesueshme për të gjithë;
- Të forcohet monitorimi i ndikimit të masave dhe raportimi periodik i rezultateve.

5. Interesat e konsumatorit

Konsumatori i energjisë ka një interes të drejtpërdrejtë dhe shumëdimensionale në përdorimin eficient dhe të qëndrueshëm të energjisë. Këto interesa lidhen jo vetëm me kostot financiare, por edhe me sigurinë, stabilitetin dhe ndikimin mjedisor të konsumit energjetik. Nga një perspektivë teknike, interesat kryesore të konsumatorit përfshijnë:

1. Reduktimi i kostove të faturave për energji elektrike, ngrohje dhe ftohje:

Efikasiteti energjetik i pajisjeve dhe menaxhimi optimal i konsumit kanë ndikim direkt në shpenzimet e përditshme të familjeve dhe bizneseve. Konsumatori kërkon zgjidhje që reduktojnë humbjet e energjisë në rrjet dhe përdorimin e panevojshëm të energjisë, duke përfshirë teknologji si termostatat inteligjente, matësit e konsumit në kohë reale dhe pajisjet me etiketim energjetik.

2. Siguria dhe stabiliteti i furnizimit me energji:

Konsumatori ka interes që furnizimi me energji të jetë i pandërprerë dhe i besueshëm, duke minimizuar ndërprerjet që mund të shkaktojnë humbje ekonomike dhe shqetësime sociale. Nga një këndvështrim teknik, kjo lidhet me monitorimin e ngarkesave në rrjet, menaxhimin e burimeve të furnizimit dhe implementimin e masave për reduktimin e humbjeve në linjat e shpërndarjes.

Miratuan me Vendimin e bordit të ERE nr. 299, datë 17.11.2025

3. Zgjidhjet miqësore me mjedisin:

Konsumatori sot është gjithnjë e më shumë i ndërgjegjshëm për ndikimin mjedisor të përdorimit të energjisë. Përdorimi i burimeve alternative si energjia diellore, energjia e erës dhe biomasë, si dhe adoptimi i pajisjeve energjitike me efikasitet të lartë, ul emetimet e karbonit dhe përdorimin e burimeve fosile. Kjo jo vetëm që kontribuon në ruajtjen e mjedisit, por edhe ndikon në përfitime ekonomike afatgjata përmes uljes së kostove të energjisë dhe stimulimeve të mundshme nga institucionet.

4. Qasje në teknologji moderne dhe efikase:

Konsumatori ka interes të ketë mundësi të përdorë pajisje dhe sisteme inteligjente që lehtësojnë menaxhimin e energjisë. Kjo përfshin panele diellore, sisteme të magazinimit të energjisë, matës inteligjent të energjisë, pajisje të lidhura në rrjet (*smart grid*) dhe teknologji për monitorim dhe kontroll në kohë reale. Këto sisteme ofrojnë jo vetëm efikasitet më të lartë, por edhe transparencë mbi përdorimin e energjisë dhe mundësi për optimizim të shpenzimeve.

5. Informim dhe mbrojtje ligjore:

Konsumatori ka interes që informacioni mbi konsumimin dhe alternativat energjetike të jetë i qartë, transparent dhe i besueshëm. Kjo përfshin raportime të sakta mbi faturat, udhëzime mbi kursimin, fushata ndërgjegjësimit dhe qasje në mekanizma mbrojtjeje ligjore. Një konsumator i informuar mund të marrë vendime të arsyeshme dhe të përfitojë nga stimujt, subvencionet dhe teknologjitë e reja për efikasitet energjetike.

6. Modalitetet e arritjes së objektivave

Qëllimi kryesor i këtij plani strategjik është rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe bizneseve për efikasitetin energjetik, përdorimin racional të energjisë dhe adoptimin e burimeve alternative, duke kombinuar fushata publike, trajnime, teknologji dixhitale dhe monitorim të avancuar të rezultateve.

1. Fushata ndërgjegjësuere publike

Fushatat ndërgjegjësuere synojnë të arrijnë një audiencë të gjerë dhe të ndryshme, duke përdorur kanale të ndryshme dhe materiale të përshtatura për çdo target grup:

- **Materiale edukative:** Broshura, manuale, video dhe infografikë që ofrojnë udhëzime praktike mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e pajisjeve me efikasitet të lartë. Infografikët do të fokusohen në statistika dhe tregues të qartë për konsumimin energjetik, kostot dhe përfitimet e adoptimit të burimeve alternative.
- **Media digjitale:** Do të përdoren platformat digjitale, rrjetet sociale dhe faqja zyrtare e ERE, në një zë të krijuar posaçërisht për këtë qëllim, për të arritur një audiencë më të re dhe teknologjikisht të avancuar. Strategjia digjitale përfshin video të shkurtra, postime interaktive dhe artikuj edukativë të përqendruar tek praktikatat e kursimit dhe teknologjitë alternative.

Miraturar me Vendimin e bordit të ERE nr. 299, datë 17.11.2025

- **Evente publike:** *Workshop*-e dhe ditë të hapura për qytetarët dhe bizneset ku prezantohen zgjidhjet praktike për eficientë energjetike dhe ekspozime të teknologjive të rinovueshme. Këto aktivitete synojnë të krijojnë përvojë të drejtpërdrejtë për përdoruesit dhe të stimulojnë adoptimin e praktikave të reja.

2. Trajnime dhe seminare për biznes dhe institucione publike

Trajnimet janë të dizajnuara për të ofruar njohuri të avancuara dhe aftësi praktike për implementimin e masave të eficientës energjetike:

- **Demonstrim i përdorimit të burimeve alternative:** Prezantimi i potencialit të paneleve diellore, turbina të vogla të erës dhe magazinimit të energjisë, si dhe analiza e kostos dhe përfitimeve të integritit të tyre në biznes dhe institucione publike.
- **Udhëzime për monitorim dhe raportim të konsumit:** Ofrimi i metodologjive standarde për matjen, raportimin dhe analizën e konsumit energjetik, duke përdorur softuerë monitorimi dhe matës inteligjentë që lehtësojnë vendimmarrjen e bazuar në të dhëna.

3. Platforma online dhe aplikacione

Teknologjia dixhitale do të luajë një rol kyç në ndërgjegjësim dhe asistencë të konsumatorit:

- **Simulime të kursimit energjie:** *Tools* interaktive që lejojnë qytetarët dhe bizneset të simulojnë kursimet që mund të realizojnë duke ndryshuar sjelljet ose duke adoptuar pajisje më efikase.
- **Llogaritës për përfitimet nga përdorimi i burimeve alternative:** Kalkulatorë që japin parashikime të kosto/përfitim, kohë amortizimi dhe ndikim mjedisor për sistemet diellore, apo ato eolike.
- **Forum dhe qasje në udhëzime teknike:** Një hapësirë interaktive ku përdoruesit mund të ndajnë përvoja, të bëjnë pyetje dhe të marrin udhëzime teknike të detajuara nga ekspertët e ERE dhe AEE.

4. Monitorimi dhe raportimi i efektivitetit

Për të garantuar rezultate të matshme dhe përmirësim të vazhdueshëm, platforma përfshin mekanizma të avancuar monitorimi dhe analizimi të performancës:

- **Raporte gjashtëmujore:** Përfshijnë analizën e aktivitetit të ndërgjegjësimit, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe bizneseve në evente, përdorimin e materialeve edukative dhe ndryshimet në praktikën e kursimit të energjisë.
- **Raporte vjetore:** Fokusohen në ndikimin në treg, adoptimin e teknologjive alternative dhe sjelljet e operatorëve të rrjetit dhe konsumatorëve, duke vlerësuar efektet mbi konsumin dhe kostot totale të energjisë.
- **Analizë e treguesve kryesorë:** Përdorimi i indikatorëve të matshëm si pjesëmarrja në aktivitetet edukative, niveli i adoptimit të pajisjeve dhe teknologjive alternative, reduktimi i konsumit energjetik dhe kursimet financiare, si dhe ndikimi mjedisor i masave të implementuara. Këto analiza do të shërbejnë si bazë për përshtatjen dhe optimizimin e strategjisë në kohë reale.

Miratar me Vendimin e bordit të ERE nr. 299, datë 17.11.2025

5. Bashkëpunimi ndërinstitucional

- ERE do të krijojë një grup pune koordinimi me pjesëmarrje nga të gjitha Strukturat e ERE që për kompetencë adresojnë çështje që lidhen me implementimin e fushatave.
- Bashkëpunimi do të përfshijë ndarjen me Agjencinë e Eficiencës të të dhënave të publikuara rast pas rasti në *Platformë, me qëllim rishpërndarjen e tyre apo publikimin e koordinuar të materialeve informative si dhe organizimit apo ndjekjes së përbashkët të aktiviteteve të planifikuara në strategji, për aq sa është e mundur.*

6. Monitorimi dhe vlerësimi i progresit

- **Treguesit kryesorë të suksesit:**
 - Numri i konsumatorëve të trajnuar ose të informuar.
 - Përdorimi i teknologjive alternative.
 - Reduktimi i kostove dhe konsumin energjetik.
 - Pjesëmarrja në platforma dhe aktivitete digjitale.
- **Raportimi dhe analiza:**
 - Raporte gjashtëmujore mbi aktivitetet edukative.
 - Raporte vjetore nga ERE mbi ndikimin në treg dhe operatorët.
 - Analiza periodike për rishikimin e strategjisë dhe përshtatjen e masave.

7. Afati kohor dhe fazat e implementimit

- **Faza 1 – Planifikimi, hartimi, miratimi:** 2025.
- **Faza 2 – Implementimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese:** 2025–2027.
- **Faza 3 – Monitorim dhe vlerësim i efektivitetit:** 2026–2029.
- **Faza 4 – Përmirësim dhe konsolidim i strategjisë:** 2028–2030.

8. Përfundim

Strategjia e ERE përbën një hap të rëndësishëm dhe themelor në përpjekjet për të modernizuar sektorin energjetik shqiptar, duke vendosur konsumatorin në qendër të procesit të menaxhimit dhe përdorimit të energjisë. Ky dokument nuk është thjesht një udhëzues politikash, por një plan i

Miratar me Vendimin e bordit të ERE nr. 299, datë 17.11.2025

detajuar dhe i integruar që lidh ndërgjegjësimin e qytetarëve, promovimin e efikasitetit energjetik dhe adoptimin e burimeve alternative me koordinimin e ngushtë ndërinstitucional.

Në thelb, strategjia synon të krijojë një platformë të qëndrueshme që mundëson edukimin e konsumatorit në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive. Përmes fushatave publike, trajnimeve, seminareve dhe përdorimit të teknologjive dixhitale, konsumatorët do të marrin njohuritë dhe mjetet praktike për të menaxhuar konsumimin e energjisë, për të reduktuar humbjet dhe kostot, dhe për të adoptuar zgjidhje të qëndrueshme energjetike.

Implementimi i strategjisë gjithashtu mundëson integrimin e teknologjive moderne në sistemin energjetik, duke përfshirë pajisje inteligjente, sisteme monitorimi në kohë reale, dhe burime alternative si energjia diellore, energjia e erës dhe biomasa. Këto masa do të rrisin efikasitetin e rrjetit, do të reduktojnë ngarkesën dhe humbjet, dhe do të kontribuojnë në një përdorim më racional dhe të optimizuar të energjisë në të gjitha nivelet – familje, biznese dhe institucione publike.

Në përfundim, strategjia nuk është vetëm një plan veprimi, por një vizion i gjerë për një sistem energjetik më të qëndrueshëm, më të sigurt dhe më efikas. Ajo krijon mundësi për qytetarët dhe bizneset të përfitojnë nga teknologjitë e avancuara, të reduktojnë kostot dhe ndikimin mjedisor, dhe të kontribuojnë në një ekonomi më të gjelbër dhe konkurruese. Zbatimi i saj do të vendosë një standard të ri për menaxhimin e energjisë në Shqipëri, duke siguruar që konsumatori të jetë jo vetëm përdorues, por edhe aktor aktiv dhe i informuar në rrjetin energjetik, dhe duke krijuar një themel të fortë për zhvillimin e qëndrueshëm energjetik në të ardhmen.